



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:051715

Datë: 02.12.2024

Numri i dokumentit: 06647995

KA.nr.342/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “NTSH M.S. Medicom” (E.O. B.I.) me NUI 811386706 dhe seli në rrugën Major Mehmet Bushi, hyrja 6, nr. 1 në Prishtinë, të cilin në bazë të prokurës e përfaqëson avokati Kushtrim Palushi me seli në rrugën Mehmet Blushi, hyrja 6, nr. 5, në Prishtinë, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, objekt i kontestit anulimi i aktit administrativ, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 02.10.2024, në të cilën përfaqësuesit e të dy palëve, më 2 dhjetor 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “NTSH M.S. Medicom” (E.O. B.I.) me NUI 811386706 kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, dhe anulohen në tërësi vendimi PSH.nr.188/20 i datës 06.04.2020 i të paditurit.
- II. Ky aktgjykim i zëvendëson aktin administrativ të anuluar me pikën I. të këtij dispozitivi dhe karakter detyrues.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 12.05.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të Paditurit, me kërkesë për anulimin e vendimit PSH.nr.188/20 të datës 06.04.2020 të Paditurit dhe kthimin e çështjes në rivendosje, ose kërkesën eventuale që të detyrohet i Padituri që t’ia shpërblej dëmin. Megjithatë, gjatë seancës së datës 02.10.2024 ka kërkuar që vetëm të anulohet akti administrativ i goditur dhe çështja të kthehet në rivendosje, ndërsa shpërblimin e dëmit nuk e kërkon më.

2. Padiësi e ka sqaruar rrjedhën e procedurës administrative në aktivitetin e prokurimit si dhe ka pretenduar se aktiviteti i prokurimit i iniciuar nga Agjencia për Menaxhim Emergjent me titull Furnizim me Aparatet e Frymëmarrjes dhe Bombolat e Ajrit ishte i iniciuar në qershor të vitit 2019 bazuar në deklaratën e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve të datës 30.04.2019 me të cilin vlera e parashikuar për këtë kontratë për 12 muaj ishte 600,000.00 euro. Më tutje ka sqaruar se, ky aktivitet i prokurimit ka qenë subjekt i 3 ankesave pranë OSHP-së, ku autoriteti kontraktues vazhdimisht nuk zbatonte vërejtjet e OSHP-së duke shpërblyer tre herë me kontratë një operator të papërgjegjshëm të njëjtë dhe duke eliminuar padrejtësisht ofertën e tij dhe kompanisë së mirënjohur Drager Safety. Gjithashtu ka deklaruar se, njoftimi i fundit për kontratë ishte dhënë me datën 23.12.2019 dhe marr parasysh afatet për trajtimin e ankesave kontrata ishte parashikuar të nënshkruhej me datën 13.01.2020 dhe mbi bazën e kësaj autoriteti kontraktues kishte konstatuar se ka bazë ligjore për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore të zotuar për këtë aktivitet të prokurimit, pavarësisht që nënshkrimi i kontratës ishte planifikuar të bëhej në fillim të vitit 2020. Sipas tij, për këtë arsye deklarimi i autoritetit kontraktues se nuk ka mjete në dispozicion, kur vet ai ishte në gjendje të nënshkruaj kontratën përkundër një pretendimi të tillë, ka qenë i pabazuar dhe ka pasur për synim ta vë në lajthim panelin shqyrtues të OSHP-së me qëllimin e vetëm që të mos lejoj të shpërblehej me kontratë ai. Për më tepër ka argumentuar se, në një situatë të tillë kur vet autoriteti kontraktues ishte në gjendje të nënshkruaj kontratë edhe gjatë vitit 2020 dhe asnjëherë nuk kishte anuluar deklaratën e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve rezulton se vendimi i kontestuar i OSHP-së është marr në zbatim të gabuar të nenit 62 të LPP-së, i cili lejon vetëm në rrethanat e kufizuara që të anulohet një aktivitet i prokurimit pas hapjes së ofertave.
4. I Padituri përmes përgjigjes në padi e ka kundërshtuar padinë dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj kërkesëpadinë. Ai ka pretenduar se, paneli shqyrtues i tij duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e ekspertit shqyrtues, ka vlerësuar se lejimi i vazhdimit të këtij aktiviteti të prokurimit do të ishte në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, për shkak se do të qonte në shkelje të ligjit mbi ndarjet buxhetore numër 07/L-001. Sipas tij, shkelja do të ndodhte për arsye se autoriteti kontraktues për këtë projekt me buxhetin e vitit 2020 i ka të aprovuara vetëm 100,000.00 euro, ndërsa ofertat te OE janë rreth 600,000.00 euro.

## II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

5. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: tabela 3.2 projektet kapitale për nivelin qendror sipas buxhetit të Kosovës për vitin 2020 të publikuara nga Ministria e Financave, Transfereve; deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve e datës 30.04.2019 me numër të prokurimit 214-19-1-111 për Agjencia e Menaxhimit Emergjent, si dhe vendimi PSH.nr. 188/20 i datës 06.04.2020 i të paditurit; vendimi PSH.nr. 15/20 i datës 05.02.2020 i të paditurit.
6. Gjykata e pati të pamundshme t'i administroj si prova shkresat e lëndës administrative siç urdhëron nenit 43 i LKA-së, meqenëse i Padituri nuk ia ka dorëzuar gjykatës shkresat e lëndës administrative, ndonëse si me aktvendimin për përgjigje në padi ashtu edhe me aktvendimin e veçantë ishte obliguar që t'ia dorëzoj ato gjykatës, duke u paralajmëruar për pasojat nga neni 37.3 të LKA-së.
7. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
8. Agjencia për Menaxhimin Emergjent, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si autoritet kontraktues, (këtu e tutje AK) më 11.06.2019 kishte hapur aktivitetin e prokurimit me titullin "Furnizimi me Aparata të Frymmarrjes dhe Bombola të Ajrit" me numër të prokurimit 21432700-19-4054-1-1-1. Në këtë aktivitet të prokurimit kishte paraqitur tender Paditësi së bashku me Drager Sfety DOO.
9. Më 27.09.2019 AK e njofton Paditësin dhe Drager Sfety DOO se ishin shpallur të papërgjegjshëm, ndërsa për kontratë e ka rekomanduar një operator ekonomik tjetër. Meqenëse AK e kishte refuzuar kërkesën e tyre për rishqyrtim, atëherë i Padituri duke vepruar në bazë të ankesës së Paditësit përmes vendimit PSH.nr.692/2019 e anulon njoftimin e AK-së për dhënien e kontratës dhe e kthen në rivlerësim procedurën.
10. Në riprocedurë, AK përsëri e shpallë të papërgjegjshme ofertën e Paditësit dhe Drager Sfety DOO dhe e rekomandon një operator ekonomik tjetër për kontratë, ndërsa si datë të planifikuar për nënshkrimin e kontratës e kishte caktuar datën 13.01.2020. I Padituri duke vepruar sipas ankesës së Paditësit e kishte dhënë vendimin PSH.nr.15/20 e kthen çështjen në rivlerësim.

11. Më 03.03.2020 AK në riprocedurë prapë e shpallë Paditësin si të papërgjegjshëm duke u bazuar në pikën 8.1 të Njoftimit për Kontratë, ndërsa një ditë më vonë, pra më 04.03.2020, e publikon njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Kundër vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit Paditësi paraqet kërkesën për rishqyrtim, të cilën AK e refuzon si të pabazuar.
12. Më 10.03.2020 Paditësi kundër vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim paraqet ankesë te i Padituri, i cili përmes vendimit të goditur PSH.nr. 188/20 të datës 06.04.2020 e refuzon ankesën e Paditësit dhe e vërteton njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit. I Padituri në procedurën sipas ankesës kishte angazhuar ekspertin shqyrtues dhe në bazë të mendimit të tij kishte konstatuar se AK për vitin fiskal 2020 i kishte vetëm 100,000.00€ në dispozicion për aktivitetin konkret të prokurimit, ndërsa meqenëse buxheti nga vitit fiskal 2019 nuk mund të bartet për vitin fiskal 2020, atëherë vazhdimi i aktivitetit të prokurimit do të paraqiste shkelje të ligjit përkatës për buxhetin e vitit 2020, rrjedhimisht aktiviteti i prokurimit duhet të përfundohet.
13. Faktet e cekura më lartë gjykata i konstatoi në bazë të vendimit të goditur dhe vendimit PSH.nr.15/20 të datës 05.02.2020 të së Paditurit.
14. Gjkata gjithashtu gjeti se për AK ishin të planifikuar 100,000.00€ nga buxheti i Republikës së Kosovës për vitin fiskal 2020. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes tabelës 3.2 për Projektet Kapitale për Nivelin Qendror për vitin 2020, e datës 16.02.2020 të lëshuar nga Ministria e Financave.
15. Përveç kësaj, gjykata konstaton se AK më 30.04.2019 kishte paraqitur deklaratën e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve lidhur me aktivitetin konkret të prokurimit në vlerë prej 600,000.00€ për 12 muaj. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes deklaratës së sapo cekur.

### III. Vlerësimi meritor i rastit

16. Gjkata pas i mori parasysh të gjitha pretendimet e ndërgjyqësve, gjendjen faktike të konstatuar, si dhe pas analizimit të dispozitave juridike të shqyrtuara më poshtë, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e Paditësit është e bazuar në ligj, rrjedhimisht ajo duhet të aprovohet dhe akti administrativ duhet të anulohet.

17. Në rend të parë, gjykata vlerësoi se i Padituri e ka zbatuar procedurën administrative në përputhje me LPPA-në dhe dispozitat procedurale të paraparë me LPP. Për më tepër, gjykata vlerëson se vendimi i goditur e ka formën e aktit administrativ në përputhje me nenin 47 të LPPA-së si dhe arsyetimi i tij i përmban të gjitha informacionet dhe sqarimet e kërkuara me nenin 48 të LPPA-së.
18. Po ashtu, gjykata vëren se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike. Gjykata rikujton se i Padituri kishte konstatuar se AK nuk kishte fonde të mjaftueshme për ta financuar realizimin e kontratës në bazë të aktivitetit të prokurimit. Ndonëse AK kishte paraqitur deklaratë të nevojave dhe me ligjin përkatës për buxhetin për vitin 2019 ishin aprovuar 600,000.00€ për aktivitetin konkret të prokurimit, megjithatë ajo sipas të njëjti ligj për vitin 2020 kishte të aprovuara vetëm 100,000.00€, që nënkupton se nuk kishte mjete të mjaftueshme për financimin e kontratës në bazë të aktivitet konkret të prokurimit. Në këtë drejtim, sipas nenit 27 të Ligjit 03/L-48 për Financat Publike dhe Përgjegjësis (i ndryshuar mes tjerash me Ligjin 04/L-194) ka paraparë se *“Të gjitha ndarjet buxhetore për vitin fiskal do të skadojnë në mesnatën e 31 Dhjetorit, me përjashtim të ndarjeve buxhetore të cilat ndërliken me të ardhurat vetanake të pashpenzuara të komunave, apo të ndonjë organizate tjetër buxhetore të cilës i janë lejuar me ligj, e të cilat barten në vitin vijues”*. Nga këto rrjedh se, mjetet e ndara buxhetore për vitin e caktuar fiskal për një organizatë buxhetore mund të shfrytëzohet deri më 31 dhjetor të vitit përkatës, ndërsa ato nuk mund të barten për fitin fiskal pasues. Duke qenë se shuma prej 600,000.00€ ishte planifikuar të shpenzohet për aktivitetin konkret të prokurimit gjatë vitit fiskal 2019, ndërsa për vitin fiskal ishin paraparë vetëm 100,000.00€, kurse kontrata në bazë të aktivitetit konkret të prokurimit e tejkalonte vlerën prej 100,000.00€, atëherë është e qartë se AK nuk ka pasur mjete financiare të mjaftueshme për financimin e kontratës në bazë të aktivitetit konkret të prokurimit.
4. Megjithatë, gjykata vlerëson se i Padituri në mënyrë të gabuar e ka zbatuar të drejtën materiale administrative. Përfundimi i aktivitetit të prokurimit është i rregulluar me nenin 62 të LPP-së, sipas të cilit:

*Neni 62*

*Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit*

*1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:*

*1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.*

*2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:*

*2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo*

*2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.*

5. Siç vërehet nga këto dispozita, arsyet e përfundimit të aktivitetit të prokurimit janë të përcaktuara në mënyrë taksative nga ligjvënësi. Vështirësitë financiare a mungesa e buxhetit të autoritetit kontraktues ose kalimi i vitit fiskal për shkak të zvarritjes së procedurës së aktivitetit të prokurimit nuk është paraparë si arsye ligjore për përfundimin e aktivitetit të prokurimit. Kjo edhe për faktin se sipas nenit 9 të LPP-së, një autoritet publik që paraqet edhe organizatë buxhetore duhet të para inicimit të aktivitetit të prokurimit të sigurohet që ka mjete mjaftueshme financimin e projektit të paraparë. Për këtë gjykatë, fakti se AK i ka pasur në dispozicion 100,000.00€ për vitin 2020 në emër të aktivitetit konkret të prokurimit, ka qenë e mjaftueshme që aktiviteti të vazhdoj dhe në gjatë vitit të paraqes kërkesë për financimin e atij aktiviteti gjatë vitit të ardhshëm fiskal.

6. Përveç kësaj, kjo gjykatë vlerëson se anulimi i aktivitetit të prokurimit për arsye që nuk janë të parapara me ligj paraqet shkelje të nenit 4 [Parimi i ligjshmërisë] dhe 8 [Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme] të LPPA-së, meqenëse është në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe Paditësi ka pasur pritshmëri legjitime që aktiviteti i prokurimit do të vazhdoj në riprocedim sipas udhëzimeve të së Paditurit të dhëna në vendimin PSH.nr.15/20 të datës 05.02.2020.
7. Shkeljet e tilla përbëjnë shkak për anulimin e aktit administrativ, të përcaktuar në nenin 52 para. 1 nënpara. 5 të LPPA-së lidhur me nenin 16 para. 1 nënpara. 1 të LKA-së, meqenëse është zbatuar gabimisht ligji material. Prandaj, gjykata gjeti se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet dhe karakteri i çështjes e lejon që gjykata të vendos me juridiksion të plotë, si dhe të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, rrjedhimisht me aktgjykim vendosi për çështjen administrative, siç mundëson neni 46 para. 4 i LKA-së. Po ashtu, në bazë të njëjtit paragraf gjykata rikujtoi se ky aktgjykim e zëvendëson aktin e anuluar.
8. Për këto arsye gjykata gjeti se vendimi i goditur është i paligjshëm, rrjedhimisht duhet të anulohet. Gjkata rikujton se, për nulitetin e aktit administrativ kujdeset sipas detyrës zyrtare, siç urdhëron neni 44 para. 2 i LKA-së.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.342/22

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.